



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.866/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e Lulzim Sylejmanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Rahovec, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Lulzim Sylejmanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Rahovec, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Rahovec, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Rahovec, në Vendvotimet: 1637A/01R, 1610A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, 1610A/04R, 1610A/05R, 1621R/01R, 1621A/02R, 1621A/03R, 1634A/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.866/2017 të datës: 10.11.2017, e parashtruar nga Lulzim Sylejmanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Rahovec, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në vendvotimet: 1637A/01R, 1610A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, 1610A/04R, 1610A/05R, 1621R/01R, 1621A/02R, 1621A/03R, 1634A/01R, gjatë rinumërimit të 700 kutive për Kuvendin Komunal ka pasur ndryshim të madh të rezultateve dhe nuk ka pasqyrim të drejt të votave sepse votat nuk janë përshkruar drejt në formularët e rezultateve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se në vendvotimet e cekura nga parashtruesi i ankesës mungojnë vota të kandidatëve nga subjekti politik PDK, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalë nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura e miratoj apelin e apeluesit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër, në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.866/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*